V E N D I M
Nr. 393, datë 15.8.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-KTHESA VAU I DEJËS (PJESË E SEGMENTIT RRUGOR LEZHË-SHKODËR)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5 pika 1 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër-kthesa Vau i Dejës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtj vendimi, për sipërfaqe 30801 m2 tokë/arë, truall 901 m2, 1 pikë karburanti me vlerë 16 772 609 lekë, 343 748 lekë kulturë bujqësore, 358 700 lekë drurë frutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 47 525 411 (dyzet e shtatë milionë e pesëqind e njëzet e pesë mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale është në shumën 498 000 lekë.

5. Fondi prej 48 023 411 (dyzet e tetë milionë e njëzet e tre mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, të përballohet nga Buxheti i Shtetit për vitin 2002, në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.8.2002.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano